



05.06.2020

01.Nr. 104/02-11486/20

Në mbështetje të nenit 13, të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës së Kaçanikut në cilësinë e Kryesuesit të Shtabit Komunal për Parandalimin e Pandemisë Covid19, me qëllim të krijimit të masave parandaluese në menaxhim të çështjes, merr këtë:

VENDIM

1. **I jepet në shfrytëzim të përkohshëm** vetura në pronësi të Komunës së Kaçanikut për Policinë e Kosovës përgjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga coronavirusi.
2. Veturat në shfrytëzim si në pikën 1 të këtij Vendimi është Land Rover me targë 05Z-02-07 në gjendje të rregullt me nr. të fletë-kërkesës 6550;
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe shfrytëzimi zgjatë varësisht nga nevoja e Policisë të Kosovës- Stacioni policor në Kaçanik.
4. Kthimi nga shfrytëzimi i veturës si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet në çdo kohë kur shihet e nevojshme nga Komuna e Kaçanikut me njoftim paraprak dhe anasjelltas.
5. Obligohet Policia e Kosovës që veturat t'i kthejë në gjendjen të cilat i ka pranuar.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë fletë-udhëtim 6550.

T'i dërgohet:

Policisë të Kosovës, Stacioni Policor Kaçanik;

Arkivit.

Z. Besim ILAZI

Kryetar i Komunës së Kaçanikut





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 400/03-12.189/20
Kaçanik; 15.06.2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Rregullores 01 Nr.05-16-39427/16 e dt.21.12.2016, Kërkesës 01Nr.104/02-11052 dhe Rekomandimit të Komisionit Komunal për ndarjen e Subvencioneve i dt.12.06.2020, Kryetari i Komunës bazuar në prioritetet dhe mundësitë buxhetore, mori këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË OVL-UÇK-së

1. Me këtë vendim lejohet ndarja e mjeteve financiare nga Buxheti i Komunës për vitin 2020, në shumë prej **3,000.00 €**, për mbulimin e shpenzimeve të operimit për vitin 2020.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi, do të realizohen nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve të Programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit 16028 dhe do të transferohen në llogarinë e OVL e UÇK me nr. 1701001010734491.
3. OVL e UÇK është e obliguar që shuma e mjeteve siq është paraparë në pikën 1. të këtij vendimi të shfytëzohet për këtë qëllim dhe ta dëshmojë me fatura apo raporte të vlefshme të parapara me nenin 23. të Rregullores 01 Nr.05-16-39427/16.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me vendim njoftohen:

1. OVL e UÇK - Kaçanik
2. Zyra e Kryetarit
3. Drejtoria e Financave dhe
4. Arkivi.

